

BLG-802811-01.

Burimet: deklarata A.T, FDH-18705; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor FDH-31815.

Beqir (Azem) Mataj

(1931, shqiptar nga Pobergja/Pobrdë, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pesë fëmijë)

Sejdi (Azem) Mataj

(20.05.1941, shqiptar nga Pobergja/Pobrdë, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pesë fëmijë)

Fane (Sadri Dulaj) Mataj

(1931, shqiptar nga Pobergja/Pobrdë, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, tre fëmijë)

Beqiri me të vëllain Sejdiun dhe të afërmen Fanen vazhduan së qëndruari në shtëpinë e Beqirit në **Pobergjë/Pobrdë**, pasi forcat serbe kanë hyrë në fshat [1.06.1998]. Për fatin e tyre nuk dihet asgjë që nga ajo ditë. Familjarët e tyre u kthyen nga mërgimi në janar të vitit 2000, por nuk arritën të mësonin asgjë për fatin e Beqirit, Sejdiut dhe Fanes. Zhdukja e Beqirit është evidentuar nga KNKK-ja në dosjen numër BLG-803309-01, ajo e Fanes me numër BLG-803310-01, ndërkaq ajo e Sejdiut BLG-803309-02.

Burimet: deklarata E.M, FDH-18709; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Zeqir (Halil) Qorraj

(20.05.1932, shqiptar nga Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, llogaritar, shtatë fëmijë)

Zeqiri me bashkëshorten Sabrijen jetonin vetëm në **Carrabregun e Ulët/Donji Crnobreg**. Fëmijët nuk i kishin në shtëpi. Kur forcat serbe filluan të sulmonin fshatin me hedhjen e predhave më 1.06.1998, Zeqiri dhe Sabrija u strehuan te farefisi në fshatin Pozhar/Požar. Të nesërmen, më **2.06.1998**, Zeqiri u nis për në fshatin e tij për të marrë disa gjësende në shtëpi, të cilat i nevojiteshin. Ishte kjo hera e fundit që Sabrija e ka parë atë të gjallë. Për fatin e Zeqirit nuk dihet asgjë as sot. Zhdukja e Zeqirit është evidentuar nga KNKK-ja dhe lënda e tij e mban numrin rendor BLG-803307-01.

Burimet: deklarata S.Q, FDH-17890; deklarata A.H, FDH-12333; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; FDH, *Që njerëzit ti mbajnë në mend njerëz*, pyetësor FDH-31815.

Sali (Mon) Binakaj

(21.04.1940, shqiptar nga Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, murator, gjashtë fëmijë)

Saliu me familje jetonin në fshatin **Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg**. Shtëpinë e kishte në afërsi të rrugës Deçan/Deçane – Gjakovë/Đakovica. Në fillim të vitit 1988, në bazë të urdhrat të policisë serbe, të gjithë ata shqiptarë që i kishin shtëpitë buzë kësaj rruge duheshin t'i braktisnin ato. Bashkëshortja e Saliut dhe katër fëmijët e tyre shkuan në fshatin Turijakë/Turijak, ndërkaq Saliu me djemtë Besimin dhe Esatin kanë mbetur në fshat. Flinin në istikamet. Saliu çonte bagëtinë në kullotë përgjatë ditës. Në datën **2.06.1998**, ai u nis në shtëpi dhe nga ajo ditë i humbet çdo gjurmë. Vetëm pas përfundimit të luftës, më 26.12.2003, policia e UNMIK-ut e ka njoftuar zyrtarisht familjen Binakaj se mbetjet mortore të Saliut ishin zhvarrosur në Serbi dhe se gjendeshin në Institutin për Mjekësinë Ligjore në Rahovec/Orahovac. Mbetjet mortore të Saliut u varrosën në varrezat e Carrabregut të Ulët/Donji Crnobreg, më 31.12.2003.

Burimet: deklarata B.B, FDH-17892; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

Besim (Bilall) Ukëhaxhaj

(10.04.1962, shqiptar nga Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, punëtor turistik, gjashtë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Faik (Jahë) Ukëhaxhaj

(15.05.1963, shqiptar nga Carrabregu i Ulët/Donji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Faiku u dënua me dy muaj burgim për shkak të organizimit të demonstratave në vitin 1981 në Deçanë/Deçane. Para vitit 1990, Besimi punonte në pushimorën e fëmijëve në Deçan/Deçane. U pushua nga puna, siç u tha, për shkak të papërshtatshmërisë morale e politike. Që ty dy i